

BASHKIA TIRANË
FORMULARI NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatori ekonomik “Gjikuria” shpk;
Njësia Bashkiake Nr. 5, Rr:“Ibrahim Rugova”, pranë gardës së Republikës, Pallati
“Kontakt”, mbi Union Bank, Tiranë.

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Procedura e prokurimit: Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim ne Njesine Administrative Vaqarr, ku jane te percaktuara 24 shtepi.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58145-05-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,(i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Publikime të mëparshme: REF-53871-03-11-2020

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” shpk &”Pepa Group” shpk &”Kacdedja” shpk; NUIS K81716011V, NUIS: K51712017A & NUIS:L42215009L.
2. Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk; NUIS: J62903456H.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” shpk &”Pepa Group” shpk &”Kacdedja” shpk

NUIS K81716011V, NUIS L42215009L dhe NUIS K51712017A

Oferta ekonomike-Alternativa 1

1. Banesë individuale 1+1, vlera 2,100,000 (dy milion e njëqind mijë) Lekë pa tvsh;
 2. Banesë individuale 1+2, vlera 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) Lekë pa tvsh;
 3. Banesë individuale 1+3, vlera 3,100,000 (tre milion e njëqind mijë) Lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk NUIS: J62903456H.

Oferta ekonomike-Alternativa 1

1. Banesë individuale 1+1, vlera 2,168,024 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë etë mijë e njëzetë e katër) Lekë pa tvsh
2. Banesë individuale 1+2, vlera 2,495,333 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa tvsh;
3. Banesë individuale 1+3, vlera 3,158,398 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Company Riviera 2008” shpk &”Pepa Group” shpk &”Kacdedja” shpk NUIS K81716011V, NUIS L42215009L dhe NUIS K51712017A

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga operatori i mësipërm ekonomik është identifikuar si oferte e pasuksesshme pasi referuar pikëzimit nuk arrin pikët maksimale.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Gjiguria” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 97.9 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, konkretisht Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Senka” shpk &”Erzeni/SH” shpk e vlerësuar me 97pikë

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 04/09/2020

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.